# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-459118**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Nga valixhet te frigoriferët: Shqiptari në Itali kapet me 414 kg hashash gati për shitje |
| ADRESA | `https://joq-albania.com/artikull/1392841.html` |
| BURIMI | joq-albania.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 20 shtator 2026, 06:50:56 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 20 shtator 2026, 06:45:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 20 shtator 2026, 06:44:00 UTC → 20 shtator 2026, 06:46:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `8dc4983a4321ae7564a61ace65a84d01860ac1a10d44749d9ec93b48cac8d7d7` |
| TEKSTI | `1919455901ac735fc396104f6ffa4babecc05fbad04fd09b67816645b6c07d60` |
| PAMJA | `c878b8dadbb202d0d62c17b5daab5039c52934869a651ce0e00377c0fd46b269` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `a8f2bb37e20a1b1023dd8015e761f5f2f2c3f34afa54fe8a114a11e9698e7a5f` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `a94744ba6f340a0d35e86c725f9a3ff2353c45c48cf148fa90ea824c18d037c8` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/a8f2bb37e20a1b1023dd8015e761f5f2f2c3f34afa54fe8a114a11e9698e7a5f`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Nga valixhet te frigoriferët: Shqiptari në Itali kapet me 414 kg hashash gati për shitje

Shkruar nga: A Shehaj | Publikuar më: 20.09.2026, 08:45

Share Share




Një 29-vjeçar shqiptar është arrestuar në Itali pasi policia zbuloi më shumë se 414 kilogramë hashash, që dyshohet se do të shpërndahej në Romë dhe zonat përreth.

Operacioni u zhvillua në Guidonia, në periferi të kryeqytetit italian. Hetuesit kishin vënë nën vëzhgim lëvizjet e të riut dhe ndërhynë në momentin kur ai po transportonte disa valixhe drejt automjetit të tij.

Kontrolli i parë çoi në zbulimin e rreth 98 kilogramëve hashash. Por hetimi nuk u ndal me kaq. Në momentin e arrestimit, policia i gjeti shqiptarit edhe një tufë çelësash, të cilët rezultuan të hapnin disa ambiente të tjera të përdorura për magazinimin e drogës.

Kontrollet në këto hapësira sollën zbulimin e një sasie shumë më të madhe lënde narkotike. Një pjesë e hashashit ishte fshehur në frigoriferë të përshtatur posaçërisht për ruajtje, ndërsa në një garazh u gjetën materiale që dyshohet se shërbenin për ndarjen dhe paketimin e dozave.

Në ambientet e kontrolluara u gjetën edhe shënime të shkruara me dorë, ku ishin regjistruar sasi dhe përllogaritje që lidhen me aktivitetin e dyshuar të trafikut.

Në total, policia italiane sekuestroi mbi 414 kilogramë hashash. Sipas autoriteteve, vlera e drogës në treg do të mund të arrinte në më shumë se 4 milionë euro.

29-vjeçari akuzohet për posedim të lëndëve narkotike me qëllim trafikimin. Gjykata vendosi të lërë në fuqi arrestimin e tij dhe caktoi masën e sigurisë "arrest në burg", raportojnë mediat italiane.

**FACT CHECK:** Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e raportoni këtu.

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR



Më të Lexuarat

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?

## TË NGJASHME




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.